



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.523/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kimete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Burim Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me ankesën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Kaçanik, për shkak të mbajtjes së tubimit elektorale pa paralajmërim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 18.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pasafatshme ankesa, e identifikuar me numër A.nr.523/2021, i datës 16.02.2021, e paraqitur nga Komisionit Komunal të Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Kaçanik, për shkak të mbajtjes së tubimit elektorale pa paralajmërim.

A r s y e t i m

Me datë 16.02.2021, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, në të cilin parashtruesi i ankesës pretendon me datën 10.02.2021 në faqen zyrtare të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Kaçanik kanë vërejtur, një tubim politik të mbajtur me gratë e qytetit të Kaçanikut, që nuk ka qenë i autorizuar nga ana e KKZ-së. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.13/2013. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga Komisioni Komunal i Zgjedhjeve me seli në Kaçanik, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Kaçanik, e datës 16.02.2021, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat” i cili përcakton se: “Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrohet pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar”. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton se parashtruesi ankesën e ka dorëzuar me postë me datë 13.02.2021 dhe e njëjta është paraqitur pranë PZAP-

it me datën 16.02.2021, ndërsa afati prej njëzetekatër (24) orëve nga momenti kur ka ndodhur shkelja e supozuar në ankesë ka qenë me datën 10.02.2021, që do të thotë se ankuesi, ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar me nenin 5 paragrafi 5 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat”.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 6 paragrafi 4 i rregullës 02/2015 “Rregullat dhe Procedurat, nenit 115 paragraf 1, dhe 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A.nr. 523/2021 me datë 18.02.2021

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet e drejta në ankesës.

